

Dosja

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA- MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.61/350-6905 datë 15.02.2022
REFERENC-Ë:	07Nr.350-6905 datë: 01.02.2022
PËR/TO:	CIMA SH.P.K. - me përfaqësues Bali Kabashi Krushicë e Poshtme-Suharekë Nr. Kontaktues:
KOPJE PËR/:	Drejtorinë e Inspeksionit Arkivin e Drejtorisë Arkivin e Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Suharekë
	DREJTOR: Visar KUQI ShSU: Nexhmije LOSHI DURMISHI
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Kushtet Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-6905 datë: 01.02.2022 nga **CIMA SH.P.K - me përfaqësues Bali Kabashi nga Krushica e Poshtme-Suharekë**, me të cilën ka kërkuar Kushte ndërtimore për ndërtimin e objektit Banesor-Afarist në parcelat kadastrale 00579-1 me sipërfaqe 632 m² dhe parcela 00579-2 me sipërfaqe 40m² sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2021 pronë e Lulezim Shales, 00578-3 me sipërfaqe 877m² dhe 00578-4 me sipërfaqe 69m² sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2021 pronë e Zymer Shales, 00577-1 me sipërfaqe 2089m², 00577-2 me sipërfaqe 108m², 00578-5 me sipërfaqe 95m² si dhe parcela kadastrale 00578-6 me sipërfaqe 29m² sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2022 pronë e Shefket Kuqit sipas kontratës për bashkë investim në ndërtimin e kompleksit Banesor-Afarist me numër noterial Nr. LRP.7101/2019, Nr. LRP.1472/2019 datë 12.11.2019. Andaj ky organ pas shqyrtimit të kërkesës ka vendosur si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj Shkrese.

AKTVENDIM RRETH KUSHTEVE NDËRTIMORE

Data: 15.02.2022
Numri i vrojtimit të lejes:
07Nr.61/350-6905
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të nenit 21 të LPH nr.04/L-174 datë:31.07.2013, nenit 18 të LN nr.04/L-110 datë: 31.05.2012, neni 13 paragrafi 4 pika 2 i UA-06/2017 Për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për Kushte ndërtimore, Leje ndërtimore dhe Leje rrënimi për kategorinë e I dhe të II të ndërtimeve, UA Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor datë:09.06.2017, Planin Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë:05.03.2008, Vendimin mbi plotësim ndryshimin e PZhU-së 01Nr.16-1413 date: 28.03.2011, Rregullorja mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve 01Nr.16-423 datë:26.01.11, Rregulloren mbi normat teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi si dhe për hapësirat në funksion të tyre, e që nuk është në kundërshtim me PZHK 2021-2029, 01Nr.016-67691 date29.10.21, Marrëveshjen për kompensimin e pronës së paluajtshëm private me bonus ndërtimi në objekt 11-463-583 datë 29.07.2021, Kontratës për bashkë investim në ndërtimin e kompleksit Banesor dhe Afarist Nr.LRP:7101-2019 Nr.i Ref.1472-2019 datë 12.11.2019 si dhe neneve 44, 47, 48 dhe 125 të LPPA nr.05/L-031, DUP në Suharekë lëshon këtë:

AKTVENDIM RRETH KUSHTEVE NDËRTIMORE
(Lagjja Kodra-Suharekë)

Ky dokument lëshohet për:			
Emri:	CIMA SH.P.K. me përfaqësues Bali Kabashi	Nr. Personal:	
Adresa:	Krushice e Poshtme-Suharekë	Telefoni:	
Email:		Kërkesa Bazë:	Kushte Ndërtimore 07Nr.350-6905 datë: 01.02.2022

Kushte ndërtimore	Sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë: 05.03.2008 Vendimin mbi plotësim ndryshimin e PZhU-së 01Nr.16-1413 datë: 28.03.2011
I. Gjendja ekzistuese e lokacionit :	
Zona Kadastrale	Suharekë
Rruga	“Adem Kuqi”, “Milit Kryeziu” dhe “Pavarsia” në Suharekë
Parcela Kadastrale	00579-1,00579-2, 00578-3, 00578-4, 00577-2, 00578-5, 00578-6, ZK Suharekë
Sipërfaqja e parcelës ndërtimore	00579-1=632m², 00579-2=40m², 00578-3=877m², 00578-4=69m², 00577-1=2089m², 00577-2=108m², 00578-5=95m²,00578-6= 29m² Sipërfaqja e parcelave kadastrale: 632m²+40m²+877m²+69m²+2089m²+108m²+95m² + 29m²=3939m²

	Sipërfaqja e parcelave ndërtimore: $632m^2+877m^2+2089m^2+95m^2=3693m^2$
Numri Referues i certifikatave	00579-1 dhe 00579-2 sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2021 pronë e Lulezim Shales, 00578-3 dhe 00578-4 sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2021 pronë e Zymer Shales, 00577-1, 00577-2, 00578-5 si dhe 00578-6 sipas certifikatës me Nr.re.11-463-273/2022 datë:26.01.2022 pronë e Shefket Kuqit.
Përpjesa e Kopjes së planit kadastral	1: 1000
Pronësia	00579-1 dhe 00579-2 prona të Lulezim Shales, 00578-3 dhe 00578-4 pronë e Zymer Shales, 00577-1 , 00577-2, 00578-5 si dhe 00578-6 pronë e Shefket Kuqit. Sipas kontratës për bashkë investim në ndërtimin e kompleksit banesor afarist me numër noterial Nr. LRP.7101/2019, Nr. LRP.1472/2019 datë 12.11.2019.
Objekte ekzistuese brenda parcelës kadastrale:	Brenda parcelave kadastrale janë rrënuar objektet ekzistuese duke u pajisur paraprakisht me Leje rrënimi 07.331/350-33020 date 03.09.2020.
Objekte ekzistuese përreth lokacionit në diametër 50m’	Përreth lokacionit gjenden objekte banimore individuale P+1 deri P+3 etj.

II. Kushte të Ndërtimit për objektin: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II- OBJEKT BANIMI DHE AFARIZËM

III.Lokacion në kuadër të: Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë: 05.03.2008

IV. Kërkesës i janë bashkangjitur dokumentacionet: Kopjet e planeve kadastrale, Certifikatat e pronësisë, kopjet e letërnjoftimit, incizimi i gjendjes faktike në teren, vërtetimet e tatimit në pronë, Kontratës për bashkë investim në ndërtimin e kompleksit Banesor dhe Afarist Nr.LRP:7101-2019 Nr.i Ref.1472-2019 datë: 12.11.2019, Marrëveshjen për kompensimin e pronës se paluajtshme private me bonus ndërtimi ne objekt 11-437-583 date 29.07.2021, Pëlqimet nga fqinjët me numrat noterial Nr.LRP.4312/2021 datë: 08.04.2021, Nr.LRP.4347/2021 datë: 08.04.2021, Nr.LRP.4371/2021 datë: 08.04.2021, Nr.LRP.4369/2021 datë: 08.04.2021, Nr.LRP.1042/2022 datë: 19.01.2022, konceptin e projektit si dhe dokumente tjera të nevojshme.

V. Gjendja e planifikuar duke u bazuar në PZHU: Lokacioni në të cilin do të ndërtohet objekti është tokë ndërtimore me destinim sipas Planit Zhvillimor Urban-Banim i përzier.

Destinimi	Banim i përzier
Ndërtimi	Ndërtim i ri
Karakter	Përhershëm me material të fortë ndërtimor
Shfrytëzimi i objektit	Objekti të shfrytëzohet për afarizëm në përdhes dhe banim kolektiv në kate.
Vija rregulluese	Nga aksi i rrugës së planifikuar “Adem Kuqi” është 7.50m’ Nga aksi i rrugës së planifikuar “Milit Kryeziu” është 6.25m’ Nga aksi i rrugës së planifikuar “Pavarsia” është 6.25m’

Vija Ndërtimore	Vija ndërtimore nga vija rregulluese e rrugës së “Adem Kuqi” është 7.00m’ Vija ndërtimore nga vija rregulluese e rrugës së “Milit Kryeziu” është 7.00m’ Vija ndërtimore nga vija rregulluese e rrugës së “Pavarsia” është 7.00m’
Përqindja e shfrytëzimit të parcelës	Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në përdhese në proporcion me sipërfaqen e parcelës ndërtimore është max.40%. (Vërejtje në përqindje llogaritet komplet pllaka bruto e objektit, me hyrje, shkallë dhe rampa).
Përqindja e shfr.të nëntokës	Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës ndërtimore (max.) 70%.
Indeksi i ndërtimit	Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto e objektit mbi kuotën 0.00 në proporcion me sipërfaqen e parcelës ndërtimore apo koeficienti i ndërtimit është marrë për bazë sipas vendimit 01Nr.-016-38192 datë 14.06.2019 lëshuar nga Kryetari i Komunës mbi të cilin është lidhë Marrëveshjen për kompensimin e pronës së paluajtshme private me bonus ndërtimi në objekt 11-437-583 datë 29.07.2021 ndërmjet palës dhe Drejtorisë për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastrë. Koeficienti i ndërtimit në këtë rast nuk mund të tejkaloj vlerën prej 2.65 të parcelave kadastrale.
Katshmëria	Etazhiteti i lejuar max B+P+4 duke mos e tejkaluar koeficientin e ndërtimit dhe kushtet tjera të definuara me plane dhe Udhëzime administrative. Etazhë e plotë konsiderohet bodrumi i cili është i ngritur max.1.4m’ mbi tokë si dhe nënkulmi (nëse përdoret) nëse pjesa vertikale e tij është më e lartë se 1.4m’. Gjatë planifikimit të etazhitetit të merret parasysh respektimi i distancave anësore nga kufijtë e parcelave kadastrale dhe ndërtimore fqinje si dhe kushtet tjera në raport me rrugët publike.
Lartësia e objektit	Varet nga etazhiteti i objektit dhe lartësitë H(neto) e tyre e që ndikon në distancat ndaj parcelave fqinjë duke mos i tejkaluar normat tjera dhe kushtet urbane të definuara me këtë dokument si dhe të jetë në harmoni me objektet fqinje. Lartësia e etazheve për afarizëm neto min.3.40m’ ndërsa për banim min.2.5m’.
Gabariti	Jo më shumë se 40% nga sipërfaqja e parcelës ndërtimore. Vërejtje: këto sipërfaqe mund të zvogëlohen në rast se kërkojnë kushtet tjera për ndërtimin e objektit.
Qasja në parcelë	Qasja në parcelë me automjete (për parking dhe garazhë) lejohet vetëm nga rruga “Adem Kuqi” si dhe duke i respektuar distancat e qasjeve me rrugët publike sipas UA.
Largësia e objektit nga kufiri i parcelave fqinje	Nga $\frac{1}{2}$ H së objektit në fasadat me dritare për ndriçim të hapësirave kryesore (qëndrim ditor, dhoma gjumi, hapësirat afariste me ndriçim natyral etj) ndërsa në fasadat me dritare vetëm për shkallë, kuzhina, sanitare dhe depo mund të jetë min. $\frac{1}{4}$ H. Distanca e objektit nga kufiri i parcelës ndërtimore përgjatë rrugëve kryesore: “Adem Kuqi”, “Milit Kryeziu” dhe rruga “Pavarsia është 7.0m’. Distanca nga objekti në objektin tjetër në rast së shkohet në formë të shkronjës U apo O (kënddrejtë) të jete sa H e objektit më të lartë. Ne rast te përdorimit te nënkalimeve per nevoja te qasjes se automjeteve kundra zjarrit te kenë gjerësi min.4.0m dhe lartësi min.5.0m.

Distanca e bodrumit nga parcela fqinje	Bodrumi përdoret për garazhim dhe nevoja ekonomike të objektit sipas rregulloreve në fuqi duke mos rrezikuar rrethinën gjatë zhvillimit të punimeve dhe duke mos krijuar disnivele në teren të panevojshme të cilat mund të pengojnë në qarkullimin e lirë të banorëve. Çdo tejkalim i nivelit të bodrumit mbi kuotën 0.0 do të llogaritet në kuadër të % së shfrytëzimit të parcelës ndërtimore si dhe koeficientit të ndërtimit andaj bodrumi preferohet të jetë nën nivelin e terenit. Pjesë të caktuara të pllakave të bodrumit të dukshme në përdhese në kuoten 00,0 të shfrytëzohen për trotuare dhe parkingje. Distanca e bodrumit nga parcelat fqinje min.1.5m’ për etazhë (vetëm në rast se nuk ndryshojnë kushtet tjera ndërtimore), asesi nuk lejohet pengimi i qarkullimit të lirë të këmbësorëve, automjeteve për nevoja të objektit si dhe të automjeteve për mbrojtje nga zjarri. Distanca e bodrumit nga rruga mund të jetë me gabarit të njëjtë me përdhesen. Në rast se e kalon vijën ndërtimore, kuota e tij nuk guxon të kalojë mbi nivelin e terenit dhe asesi nuk guxon ta tejkalojë vijën rregullative.
Arkitektura	Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë dhe t’i përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar. Objekti të projektohet në harmoni me fasadat e objekteve fqinje me një lidhje të mirë arkitektonike dhe funksionale.
Kuota e përdhesës	Kuota e përdhesës me destinim afarizëm është max.30cm’ mbi nivelin e trotuarit ndërsa nëse përdhesa ka destinim banim max.80cm’ duke i respektuar edhe kushtet ndërtimore të cituara më lartë.
Numri i hyrjeve	Hyrja kryesore për banim, hyrjet për afarizëm dhe hyrja ekonomike.
Konzola	Për mbulim të hyrjeve apo terasave në përdhesë dhe kate jo më shumë se 1.8m’ nga fasadat e objektit (të cilat duhet të jenë në vije ndërtimore), por asesi ti kaloj rregullat tjera të definuara me Kushte ndërtimore dhe normat tjera të planifikimit.
Lloji i kulmit	Kulmi mund të jetë i pjerrtë apo i rrafshët i projektuar sipas standardeve të planifikimit i pa shfrytëzuar, duke pas parasysh kushtet dhe rregullat tjera të definuara me plane dhe udhëzime administrative.
Hapësi.ndihmëse	Të planifikohen në kuadër të objektit
Njësit banesore	Projektimi i njërive banesore të bëhet konform Rregullores për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi.
Ha. për këshillim shtëpiak	Në hyrje të ndërtesës duhet të ketë një hapësirë të përbashkët shumë funksionale me sipërfaqe së paku 1.5m ² për njësi të banimit dhe duhet të ketë njëjën sanitare.
Shkallët dhe ashensori	Gjerësia minimale e krahut të shkallëve tek ndërtesat deri në 5 kate mbi nivel e tokës duhet të jetë min.120cm’, ndërsa për ndërtesat mbi 5 kate mbi nivelin e tokës gjerësia min.150cm’, ndërsa gjerësia e pushimores duhet të jetë e njëjtë me krahun u shkallëve. Ashensorët te ndërtesat e banimit me më shumë se 4 kate nën dhe mbitokësore duhet të kenë këto dimensione (110cmx210cmx220cm), në rastet kur numri i banesave është 40 deri në 60 pavarësisht kateve duhet të shtohet edhe një ashensor me dimensione (110cmx110cmx220cm). Komunikimi vertikal të projektohet sipas normave për mbrojtje nga zjarri.
Parkingjet	Për afarizëm duhet të sigurohet 1 vend parking për 30m ² (neto), 1vendparking për 1 njësi banimore nen100 m ² si dhe1.5VP për njësi banimore mbi 100m ² , ku 30% e parkingut të vendoset jashtë objektit në përdhes (niveli 0.00) dimensione

	(250x455)cm për pozitë 90° dhe (250x485)cm për pozitë 45° ndërsa pjesa tjetër nëntokë. Për çdo 20 hyrje banimore shtohet një vend parking për personat me aftësi të kufizuara ose nga parkingu i përgjithshëm duhet të jetë 5% me dimensione sipas normave. Hapësirat e parkimit mbi tokë preferohet të gjelbërohen me gjelbërim dhe të shtrohen me elemente betoni që mundësojnë rritjen e barit. Të analizohen hyrjet-daljet nga vend parkingjet, rrugët me rreze të kthimit sipas standardeve si dhe të respektohen normat për rampa. Në budrum duhet të planifikohet 2m ² depo për 1 njësi banimore me lartësi min. 220cm nese nuk është paraparë në kuadër të njësisë banimore.
Gjelbërimi	Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës ndërtimore min. 30 %.
E drejta e ndriçimit natyror	Mënyra e projektimit të ndriçimit bëhet në përputhje me rregulloren e MMPHI-së. Sipërfaqja minimale e hapjes në fasadë për ndriçim natyror të hapësirës për banim llogaritet 20% e sipërfaqes neto të dyshemesë së asaj hapësire, përveç për dhomë të ditës dhe dhomë për shumë qëllime duhet të jetë 25% e sipërfaqes neto të dyshemesë së asaj hapësirë. Nuk lejohet ndriçimi i qëndrimit ditor nga atriumi (oaza e gjelbër) nëse distanca në mes fasadave është më e vogël së 1H.

Vërejtje: Gjatë hartimit të dokumentacionit teknik për objektin e ri, duhet të respektohet forma e parcelës në raport me objektin, qarkullim efikas, me arkitekturë të qëndrueshme duke i dhënë rëndësi ruajtjes së energjisë dhe reduktimi i ndikimeve negative në mjedis.

VI. Kushtet kyçese në infrastrukturë: Kyçja në infrastrukturë të bëhet në rrjetet ekzistuese pas sigurimit të kushteve detale dhe pëlqimeve për kyçje nga:

- KEDS- njësia në Suharekë
- Ujësjiellësi dhe kanalizimi— kompania Hidroregjioni Jugor njësia në Suharekë
- Mbeturinat- Ekoregjioni në Suharekë
- Pëlqim për kyçje në komunikacion – nga inspektori i komunikacionit
- Pëlqim sanitar – nga inspektori i sanitarisë
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri nga DSHPME-Komuna Suharekë
- Leje Mjedisore Komunale nga DSHPME-Komuna Suharekë
- Projektin e ashensorëve
- Elaboratin gjeomekanik
- Koordinatat e vendosjes së objektit (përdhesis dhe bodrumit) sipas kushteve ndërtimore nga gjeodeti i licensuar.
- Bashkimin e parcelave kadastrale në një parcelë ndërtimore.

VII. Kushtet për rregullimin e parcelës ndërtimore (hapësira):

Kushtet për rregullimin e parcelës ndërtimore të paraqiten në mënyrë grafike në përpjesën 1:500, 1:250 dhe të jenë pjesë e projektit kryesor ku do të përmbajnë, etazhitetin, gabaritin e objektit, distancat nga fqinjët, vijën ndërtimore, vijën rregullative, hyrjen, pjerrtësitë e pullazit, dimensionet e parcelës, qasjen në rrugë, parkingun, gjelbërimin, rrethojën ose jo të parcelës.

VIII. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë :

- Të dhënat e zyrës projektuese: certifikatën e biznesit, diplomat e inxhinierëve të lëmive përkatëse,
- Deklarata e projektuesit kryesor që projekti është në harmoni me kushtet e dhëna, vendimet dhe rregulloren e komunës si dhe me dispozitat ligjore në fuqi.
- Dokumentacioni i hartuar teknik në përpjesë 1:50 të dorëzohet pranë DUP, në tri kopje origjinale (për palën, dosjen dhe Insp. e ndërtimit) dhe në CD të lidhura (që e mundëson qëndrueshmërinë e tij në kohë) dhe të vulosura nga kompania projektuese e licensuar.

KES • OPSTINA SUHAREKE

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës.
 - Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë.
 - Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore.
 - Përshkrimi teknik me specifikacionin detal të sipërfaqeve bruto dhe neto të objektit (ky dokument është bazë për kalkulimin e taksës ndërtimore).
 - Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhes dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute.
 - Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë.
 - Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20.
 - Të gjitha fazat e projektit me paramasa dhe parallogaritë, përshkrime, vizatime dhe detale të nevojshme për zbatimin e projektit në teren.
 - I gjithë projekti duhet të jetë i nënshkruar nga projektuesit (inxhinier të diplomuar të profesioneve përkatëse) dhe vërtetuar me vulën e zyrës së projektimit.
- Vërejtje:** Para dorëzimit të projektit një kopje të sjellët pranë drejtorisë për të kontrolluar se a është në përputhshmëri me kushtet e dhëna. Në qoftë se projekti kryesor nuk i përmbahet kritereve të projektimit, informatave të dhëna me këtë dokument dhe kushteve të definuara me PZHU do të kthehet në plotësim apo ndryshim.

IX. Këto kushte vlejnë 1 vjet duke llogaritur nga data e lëshimit të tyre. Vazhdimi i vlefshmërisë së këtyre kushteve mund të bëhet edhe për një vit tjetër nëse nuk është ndryshuar pjesa e planit urbanistik në bazë të të cilit është lëshuar ky dokument.

Vërejtje: Pala duhet që një muaj para skadimit të afatit të filloi procedurën e marrjes së Lejes së Ndërtimit, në të kundërtën kushtet nuk janë të vlefshme nëse e kalon afatin një vjeçar dhe pala duhet të i nënshtrohet riprocedimit.

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtyre kushteve pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në MMPHI brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes së dokumentit.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.61/6905 datë 15.02.2022, Suharekë

Informata i dërgohet:

Palës,
 Inspektoratit të ndërtimit,
 Dosjes së DUP-së,
 Arkivit të Komunës.



Faqe 7 nga 7

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë
 Telefon: 029 271 318
 www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net